



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . 2022

**KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE  
DHE TË DREJTAT E NJERIUT**

Në zbatim të pikës 2, të nenit 19, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.7, datë 28.02.2018, “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” si dhe udhëzimit nr. 9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, po ju parashtrojmë dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, për periudhën 2023-2025, faza strategjike, miratuar me vendimin nr. 04, datë 04.05.2022, të Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Grupit për Menaxhimin Strategjik të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, sipas këtij materiali dhe dokumenteve bashkëlidhur.

Kolegji i Posaçëm i Apelitit (këtu e në vijim Kolegji) është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si një ndër tre institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Referuar nenit 179/b, pika 5 të Kushtetutës, Kolegji funksionon pranë Gjykatës Kushtetuese, si kolegji i dytë i saj. Gjyqtarët e Kolegjit, referuar pikës 3 të nenit C, të Aneksit të Kushtetutës, gjatë mandatit të tyre gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Në përmbushje të detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji, Kolegji mbështetet nga Njësia e Shërbimit Ligjor dhe punonjësit administrativë. Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin nr.92/2017, i ndryshuar me Vendimin nr. 82/2020, ka miratuar strukturën organizative, organikën dhe klasifikimin e pagave të personelit të Kolegjit të Apelitit, sipas të cilit, numri total i punonjësve është 49 (dyzetë e nëntë).

Për procesin e hartimit të kërkesave buxhetore afatmesme të Kolegjit të Apelitit për Fazën Strategjike janë ndjekur këto hapa:

1. Përcaktimi i misionit të institucionit dhe përshkrimi i programit buxhetor;
2. Përcaktimi i qëllimit të politikës dhe objektivave të programit;
3. Përcaktimi i treguesve të performancës për çdo objektivi të programit;
4. Formulimi i produkteve mbi bazën e rezultateve të përcaktuara;
5. Ndarja e kërkesave buxhetore sipas politikave ekzistuese dhe politikave të reja;

**Misioni i KPA-së është:** “Përmbushja e funksioneve dhe kompetencave ligjore për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”.

Kolegji i Apelitit funksionon me një program të vetëm buxhetor me emërtesën: “Veprimtaria e Apelitit të Rivlerësimit Kalimtar”.

**Përshkrimi i Programit:** “Mbështetja e veprimtarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelitit për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; ushtrimin e juridiksionit disiplinor ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj si dhe shqyrtimin e

*ankimeve kundër vendimeve të organeve të sistemit të drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore”.*

**Qëllimi i Politikës së Programit:** *“Funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”.*

Si tregues i performancës i projektuar për të matur impaktin e këtij qëllimi është përcaktuar: *“Pavarësia dhe funksionimi i sistemit ligjor”.*

Përcaktimi i vlerës bazë si dhe vlerës për tre vitet e ardhshme, për efekt të procesit të parashikimit të kërkesave buxhetore afatmesme, është kryer duke përdorur si burim informacioni studimet vjetore të publikuara nga “Freedom House”, organizatë e pavarur, financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, e specializuar në studime mbi demokracinë, respektimin e lirive dhe të drejtave si dhe funksionimin e shtetit (<https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2022>).

Sa i përket vlerësimit të sistemit gjyqësor ky studim paraqet rezultatet në formën e një indeksi me vlera nga 0 - 4, ku nr. 0 paraqet vlerësimin minimal dhe nr. 4 atë maksimal. Në raportin e vitit 2022, ku paraqitet vlerësimi për vitin 2021, sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, paraqitet në nivelin 2.

Ne gjykojmë se si rrjedhojë e thellimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe krijimit e konsolidimit të organeve të reja të drejtësisë në vitet në vijim ky indeks do të vijë drejt një përmirësimi gradual nga niveli 2.5 në vitin 2023, në nivelin 3 deri në vitin 2025.

Për realizimin e programi buxhetor është përcaktuar si objektiv kryesor:

**Objekti i 1 -** *“Të shqyrtojë çështjet e ankimuar në juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor”.*

Treguesi i performancës i projektuar për të matur rezultatin e lidhur me këtë objektiv është: *“Numri i çështjeve të përfunduara në raport me numrin e çështjeve të ankimuar”.* Vlera e projektuar për këtë tregues performance për periudhën 2023-2025, është vlerësuar në masën 50%.

Deri më datën 31 dhjetor 2021, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar për shqyrtim 251 çështje të juridiksionit të rivlerësimit (40 çështje gjatë vitit 2018 , 62 çështje gjatë vitit 2019, 63 çështje gjatë vitit 2020 si dhe 86 çështje gjatë vitit 2021).

Deri më datën 31 dhjetor 2021, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë shpallur 126 vendime të juridiksionit të rivlerësimit ose rreth 50% e çështjeve të regjistruara.

Si produkt kryesor për realizimin e objektivit 1 është përcaktuar *“Çështje të ankimuar /shqyrtuara”*, duke parashikuar dhe numrin e çështjeve për periudhën 2023-2025.

Nga të dhënat statistikore të deritanishme, rezulton se nga rreth 805 subjekte rivlerësimi ne total, është ndërprerë procesi i rivlerësimit për 28 subjekte (ndërprerja e vetingut për shkak të moshës moshës dhe dorëheqjeve). Nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, deri në muajin dhjetor 2021, janë dhënë rreth 495 vendime. Bazuar në përcaktimet ligjore, të gjitha çështjet e shqyrtuara nga KPK, janë potencialisht të mundshme për ankimim pranë Kolegjit të Apelit, megjithatë nga të dhënat e deritanishme rezulton se rreth 50% e vendimeve të dhëna nga KPK-ja janë apeluar pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Sa i takon të drejtës së ushtrimit të juridiksionit disiplinor ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj si dhe shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të organeve të sistemit të drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, aktualisht Kolegji i Apelit deri në 31 dhjetor 2021, ka shqyrtuar 14 çështje në total, nga të cilat 11 çështje janë regjistruar vetëm gjatë vitit 2021, si dhe janë shpallur 7 vendime që i përkasin këtij juridiksioni.

Bazuar në sa më sipër, për efekt planifikimi buxhetor, për vitin 2023, kemi parashikuar si potencialisht të ankimueshme për tu gjykuar nga Kolegji i Apelit 90 çështje (80 çështje të juridiksionit të rivlerësimit dhe 10 çështje të juridiksionit disiplinor). Për 2 vitet e tjera buxhetore, numri i çështjeve potencialisht të ankimueshme parashikohet i njëjtë.

Kërkesa buxhetore për vitin 2023 është e orientuar në tre zëra shpenzimesh:

1. Shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore);

2. Shpenzime operative;
3. Investime;

Buxheti total i parashikuar për mbështetjen e veprimtarisë së Kolegjit të Apelimit për vitin 2023, është **239.2 milionë lekë**. Tavani buxhetor i përcaktuar për vitin 2023 është **186 milionë lekë**.

**Pavarësisht përcaktimit të mësipërm, në zbatim të Aneksit të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë, neni C, pika 14 e tij, si dhe nenit 19, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kërkesat buxhetore për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë hartuar bazuar në nevojat konkrete dhe nuk marrin në konsideratë tavanet indikative të miratuara për KPA-në, me VKM nr. 130, datë 02.03.2022 “Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të PBA-së 2023-2025”.**

Pas dorëzimit të kërkesave buxhetore afatmesme 2022-2024 (faza teknike), nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk janë referuar vërejtje apo rekomandime lidhur përgatitjen e kërkesave buxhetore nga Kolegji.

Në materialin në vijim, paraqitet në mënyrë të detajuar dhe argumentuar kërkesa për çdo artikull ekonomik, për vitin 2023.

## **1. Shpenzimet e personelit**

Kërkesat buxhetore në shpenzime personeli, për vitin 2023, janë përllogaritur në vlerën totale **202.5 milionë lekë** dhe përfshijnë:

- a) Vlerën **175.4 milionë lekë** paga dhe sigurime shoqërore për 49 (dyzet e nëntë) punonjës të miratuar me Vendimin nr. 92/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, ndryshuar me Vendimin nr. 82/2020, si dhe 6 (katër) punonjës me kontratë të përkohshme përcaktuar në VKM-në nr. 35, datë 19.01.2022. Ky fond konsiston përkatësisht në: 161.8 milionë lekë për paga dhe 13.6 milionë lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Në përllogaritjen këtij fondi jemi mbështetur në:
  - Pikat 3, 4 dhe 5, neni 29, ligji 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 17, ligji nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; i ndryshuar, neni 12, ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar, VKM nr. 574, datë 9.10.2017 “Për përcaktimin e pagës mujore shtesë për shkak të vështirësisë, për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit”, vendimin nr. 17, datë 30.07.2019, të Mbledhjes së Gjyqtarëve “Kriteret e dhënies së pagesës së vështirësisë për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor”, **sa i takon Gjyqtarëve të Kolegjit të Apelimit, Këshilltarëve të Njesisë së Shërbimit Ligjor.**
  - Vendimin nr. 92/2017 të Kuvendit të Shqipërisë i ndryshuar me Vendimin nr. 82/2020, VKM nr.187, datë 8.3.2017, VKM nr.234, datë 20.04.2022, **sa i takon punonjësve administrative.**
  - Aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për pagesën e kontributit të sigurimit shoqëror dhe kontributit të sigurimit shëndetësor që punëdhënësi kryen për punëmarrësit.
  - Efektin prapaveprues për periudhën dhjetor 2018- shkurt 2021, në llogaritjen e pagave dhe sigurimeve shoqërore për gjyqtarët dhe këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, në zbatim të pikës 5, të nenit 12 të ligjit 96/2016, sipas rekomandimit në Raportin Përfundimtar të Auditit të ushtruar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, si dhe vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 17, datë 21.02.2021, “Për auditimin tematik, të përputhshmërisë, të ushtruar në bazë të autorizimit për verifikimin e përllogaritjes së pagave, me fokus të veçantë ndër të tjera vjetërsinë në punë si dhe kuadrin ligjor e rregullator mbi të cilin mbështetet përllogaritja e tyre, të ushtruar në KLGJ”.

Bazuar në përcaktimet e udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 28.02.2018 “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, kërkesa për shpenzime personeli për vitin 2023, për numrin organik 55(49 + 6) punonjës, është konsideruar si pjesë e **politikës ekzistuese** të Kolegjit të Apelimit.

b) Vlerën **27.1 milionë lekë** paga dhe sigurime shoqërore ku janë përllogaritur ndryshimet e kërkuara në strukturën organike lidhur me:

- **Një shtesë prej 8 (tetë) punonjës, përkatësisht 3 (tre) këshilltarë ligjor, 2 (dy) këshilltarë ekonomikë, 2 (dy) specialistë sekretarie gjyqësore dhe 1 (një) specialiste për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve.**

Kjo kërkesë e përfshirë dhe në programin buxhetor afatmesëm 2022-2024, është argumentuar nga Kolegji, gjatë diskutimeve të kryera për miratimin e buxhetit të vitit 2022, në komisionin e ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë.

Efekti financiar për shtesën e kërkuar të punonjësve për vitin 2023 është 22.3 milionë lekë për paga dhe 2.1 milion lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Ky parashikim buxhetor dhe është konsideruar si **politikë e re**, pasi për këto propozime nevojiten ndryshime në bazën ligjore aktuale.

- **Një rritje në klasifikimin e pagave për 3(tre) poste pune specialistë të profileve të ndryshme (specialist pritje populli/ specialist zbardhje vendimi/ specialist protokoll) nga kategoria e pagës IV-a në kategorinë e pagës III-b.**

Kjo kërkesë e përfshirë dhe në programin buxhetor afatmesëm 2022-2024, është argumentuar nga Kolegji, gjatë diskutimeve të kryera për miratimin e buxhetit të vitit 2022, në komisionin e ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë.

Efekti financiar i këtij ndryshimi është 504 mijë lekë (përkatësisht 432 mijë lekë paga dhe 72 mijë lekë sigurime shoqërore) dhe është konsideruar si **politike e re**, pasi për këtë propozim nevojitet miratim ligjor.

- **Një shtesë në pagat e punonjësve administrativ në masën 10% të shtesës për pozicion/ pagës bazë për klasë.**

Kjo kërkesë e përfshirë dhe në programin buxhetor afatmesëm 2022-2024, është argumentuar nga Kolegji, gjatë diskutimeve të kryera për miratimin e buxhetit të vitit 2022, në komisionin e ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë.

Efekti financiar i këtij ndryshimi është 2.190 mijë lekë (përkatësisht 1.991 mijë lekë paga dhe 199 mijë lekë sigurime shoqërore) dhe është konsideruar si **politike e re**, pasi për këtë propozim nevojitet miratim ligjor.

Pas vendimarrjes nga Kuvendi i Shqipërisë, për miratimin e kërkesave të mësipërme (sipas pikës b), efekti financiar i tyre do të konsiderohet si politikë ekzistuese në fazën e dytë teknike të PBA - së 2023-2025.

Për dy vitet e tjera të PBA-së 2024 dhe 2025, kërkesa buxhetore për shpenzime personeli është **181.5 milionë lekë**.

## 2. Shpenzime Operative

Buxheti për shpenzime operative, përfshin tërësinë e mallrave dhe shërbimeve të domosdoshme gjatë aktivitetit vjetor në mbështetje të ushtrimit të funksioneve që Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, i ngarkon Kolegjit të Apelimit.

Në përllogaritjen e fondeve buxhetore për shpenzime operative, jemi mbështetur kryesisht në:

- Treguesit e realizuar të shpenzimeve operative për vitin 2019 - 2021 dhe shpenzimeve të parashikuara për vitin 2022, si dhe kërkesat specifike të paraqitura nga dy drejtoritë.

Buxheti total i parashikuar në shpenzime operative për vitin 2023, për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit është **23.6 milionë lekë**.

Në vijim, janë paraqitur kërkesat për vitin 2023, sipas grupeve kryesore të shpenzimeve operative:

## 602.0 - Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme

Kjo kategori shpenzimesh e përlogaritur në vlerën **3.2 milionë** lekë përfshin zërat e mëposhtëm:

*në 000 lekë*

Kancelari, letër	700
Materiale për pastrim e higjieno sanitare	600
Materiale elektrike, ndricim etj	100
Materiale për funks.e zyrave (tonera)	1.000
Pjesë ndërrimi fotokopje, printera, kompjuterë	600
Materiale për funks.pajisjeve speciale	100
Materiale tjera zyre dhe të përgjithshme	100

-Në zërin materiale për funksionimin e zyrave (tonera) janë parashikuar nevojat vjetore për vitin 2023, që do të përfshihen në procedurën e prokurimit të llojit marrëveshje kuadër për 3 vite, që do të zhvillohet vitin e ardhshëm, në përfundim të marrëveshjes kuadër aktuale të lidhur në vitin 2020.

-Në zërin pjesë ndërrimi fotokopje, printera, kompjuterë për pjesë të konsumueshme që lidhen me frekuencën e përdorimit, bazuar kjo në raportin e hartuar nga specialist IT i Kolegjit.

## 602.1 - Materiale dhe shërbime speciale

Kjo kategori shpenzimesh e përlogaritur në vlerën **600 mijë** lekë përfshin zërat e mëposhtëm:

*në 000 lekë*

Uniforma dhe veshje speciale	50
Furnizime me ujë të pijshëm për seancat dhe personelin	200
Ilace dhe materiale mjekësore	10
Abonim ne shtypin e shkruar	100
Shpenz.për prodhim dokumentacioni specifik	80
Dezinfektim i ambienteve	60
Të tjera mater.dhe shërbime speciale	100

- Në zërin uniforma dhe veshje speciale janë parashikuar fondet për pajisjen me toga gjyqësore të specialistëve të sekretarisë gjyqësore.

- Në zërin ujë i pijshëm, është parashikuar mbulimi i nevojave për personelin e Kolegjit si dhe palët pjesëmarrëse gjatë proceseve gjyqësore.

- Në zërin dezinfektim i ambienteve, është planifikuar dezinfektimi kundër insekteve që mbartin patogjenë të dëmshëm për shëndetin e njeriut me një frekuencë 3 herë/vit.

## 602.2 - Shërbime nga të tretët

Kjo kategori shpenzimesh e përlogaritur në vlerën **3.8 milionë** lekë përfshin zërat e mëposhtëm:

*në 000 lekë*

Elektricitet	1.700
Ujë	150
Shërbime telefonike	1.000
Posta dhe shërbim korrieri	110
Sherbime bankare	5
Kosto të trajnimit dhe seminarëve	150
Shërbime të printimit dhe publikimit	500
Shërbim interneti për ambiente me qira	50
Shërbime të tjera	100

- Në zërat elektricitet dhe ujë, përveç konsumit në godinën aktuale, është parashikuar dhe konsumi për ambiente shtesë në dispozicion të Kolegjit nëpërmjet qiramarrjes, sipas miratimit nga Këshilli i Ministrave në shkresën nr. 4140/1 prot., datë 24.11.2021.



- Në zërin kosto të trajnimit dhe seminarëve, janë parashikuar trajnime për stafin administrativ, të organizuara nga shkolla e administratës publike, sipas tarifave të parashikuara në VKM-në nr. 687, datë 18.11.2021.
- Në zërin shërbime telefonike në zbatim të VKM-së nr. 855, datë 02.11.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 02.09.2020, “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë” si dhe Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020, i cili ka miratuar kuotat maksimale për telefoninë celulare sipas funksioneve, është llogaritur vlera e kontratës institucionale për titullarin e institucionit, këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë, Sekretarin e Përgjithshëm dhe drejtorët e Drejtorive.
- Zëri shërbime printimi dhe publikimi ka të bëjë me publikimet në median e shkruar dhe atë online të pozicioneve vakante të punësimit për shtesat në strukturë si dhe pozicionet vakante që mund të krijohen gjatë vitit në institucion.

### 602.3 - Shpenzime transporti

Kjo kategori shpenzimesh e përlogaritur në vlerën **540 mijë lekë** përfshin zërat e mëposhtëm:

*në 000 lekë*

Karburant për automjetin dhe gjeneratorin	250
Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	30
Shpenzime siguracioni të mjeteve	60
Shpenzi të tjera transp (parkim per automjetin )	200

-Në zërin karburant gjatë vitit 2023, është parashikuar një sasi prej 1200 litër (100 litër / muaj) për automjetin e institucionit.

-Në zërin “pjesë këmbimi, goma dhe bateri” me vlerë 30 mijë lekë, është vlerësuar prokurimi i një baterie për automjetin e institucionit, sipas vlerësimit të kryer nga shoferi i automjetit.

-Në zërin shpenzime të tjera transporti është përfshirë rinovimi i kontratës me Bashkinë Tiranë për vend parkimin e automjetit të institucionit.

### 602.4 - Shpenzime udhëtimi

Kjo kategori shpenzimesh e përlogaritur në vlerën **3.2 milionë lekë** përfshin zërat e mëposhtëm:

*në 000 lekë*

Udhëtim i brendshëm	500
Udhëtim jashtë shtetit	2.700

- Lidhur me udhëtimet e brendshme, është parashikuar një fond, duke u bazuar në nenin 49, pika Ç, e ligjit 84/2016, ku parashikohet se me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Kolegji ka të drejtë të këqyrë dhe kontrollojë sende të luajtshme apo të paluajtshme, bazuar në vendimin e gjykatës kompetente, si dhe zhvillimi i dy seminarëve brenda Shqipërisë, në kuadër të juridiksionit disiplinor.

- Në zërin udhëtime jashtë vendit nisur nga fakti që anëtarët e Kolegjit, mund të marrin pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare, takime apo trajnime me organe të juridiksionit disiplinor, për proces të rregullt gjykimi e shkëmbim eksperience, është parashikuar mbulimi i shpenzimeve për 1 (një) udhëtim 3 ditor për shtatë gjyqtarë për vizita studimore në gjykata homologe; 1 (një) udhëtim 4 ditor për 7 (shtatë) këshilltarë në Njësisë së Shërbimit Ligjor për trajnim në kuadër të Juridiksionit Disiplinor në GjEDNJ apo gjykata evropiane, të cilat kanë në juridiksionin e tyre procedime disiplinore. Gjithashtu në këtë zë është përfshirë dhe një udhëtim 3 ditor për personelin (3 persona/udhëtim) për takimet vjetore të Komitetit të Stabilizim Asociimit, në Bruksel. Baza ligjore për shpenzimet e parashikuara më sipër është VKM nr. 870, datë 14.11.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”

### 602.5- Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme

Kjo kategori shpenzimesh e përlogaritur në vlerën **1.3 milion lekë** përfshin zërat e mëposhtëm:

*në 000 lekë*

Shpenzime për mirëmbajtjen sistemeve dhe instalimeve	1.085
Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit	120
Shpenzime për mirëmbajtjen dhe riparim paisje zyre	100

Në zërin mirëmbajtje e sistemeve dhe instalimeve teknike janë përfshirë:

a. Mirëmbajtja e serverëve të institucionit në vlerën 1.000 mijë lekë, si kërkesë ligjore përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 21 gusht 2013 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit". Aktualisht në Kolegj janë të instaluar dy serverë HP, për transmetimin dhe ruajtjen e të dhënave.

b. Mirëmbajtja vjetore e sistemit audio-video të instaluar në sallën e gjyqit si pjesë e kontratës së nënshkruar me operatorin ekonomik me vlerë 85 mijë lekë.

#### **602.6- Shpenzime për për qiramarrje ambientesh**

Buxheti i detajuar për këtë kategori shpenzimi është përlloritur në vlerën **1.7 milion lekë** dhe përfshin marrjen me qira të ambienteve të shtesë, me një sipërfaqe 120-150 m<sup>2</sup>, në godina të vendosura afër selisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas miratimit nga Këshilli i Ministrave, me shkresën nr. 4140/1 prot., datë 24.11.2021.

#### **602.9 - Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative**

Kjo kategori shpenzimesh e përlloritur në vlerën **9.3 milionë lekë** përfshin zërat e mëposhtëm:

*në 000 lekë*

Shpenzime për sigurimin e jetes, shëndetit dhe pasurisë	7.000
Shpenzime telefonie gjyqtarë	1.080
Shpenz kompesimi për pasaportë diplomatike	60
Shpenzime për tatim & taksa për institucionin	100
Blerje license Firewall	510
MKZ	20
Blerje materiale hidraulike, marangozi, ndertimi etj.	100
Dekorim i festave të fundvitit	20
Blerje licensash Microsoft Office 365 dhe Zoom meeting	120
Mirëmbajtje faqe zyrtare	280

- Në zërin sigurimi i jetës, shëndetit dhe pasurisë, bazuar në pikën 17, të nenit "C" të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 25, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", është parashikuar një fond 4.1 milionë lekë për rinovimin e paketës ekzistuese për gjyqtarët dhe personat e lidhur si dhe 2.3 milionë lekë për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe stafin administrativ (duke patur parasysh të njëjtën paketë sigurimi të miratuar për vitin 2021). Gjithashtu është parashikuar një fond shtesë në vlerën 600 mijë lekë, për përfshirjen në skemën e sigurimit të shtesës së kërkuar në numrin e këshilltarëve në Njësine e Shërbimit Ligjor dhe stafit administrativ.

- Në zërin shpenzime telefonie për gjyqtarët, është parashikuar fond 15 mijë lekë/muaj për mbulimin e shpenzimeve telefonike për kontratat individuale të gjyqtarëve të Kolegjit, bazuar në VKM-në nr. 855, datë 02.11.2020, dhe Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020, dhe kontratat aktuale të gjyqtarëve.

- Në zërin blerje license firewall është parashikuar fondi i nevojshëm për rinovimin e licensave për pajisjen firewall me një afat 3-vjeçar, në kushtet kur ky shërbim i prokuruar në vitin 2020, përfundon në vitin 2023.

- Në zërin blerje licensash përveç rinovimit të shërbimit Microsoft Office 365 është përfshirë dhe rinovimi i shërbimit Zoom Meeting për punën në distancë.

- Në zërin mirëmbajtje e faqes zyrtare për vitin 2023, përveç shërbimit të mirëmbajtjes së faqes në nivelin "root", që ka të bëjë me menaxhimin e rubrikave dhe përditësimet e nevojshme të software-ve për një funksionim optimal gjatë përdorimit të saj, pas vlerësimit të kryer nga specialistët IT të Kolegjit, si dhe auditimit të faqes zyrtare të kryer nga AKSHI pas sulmeve

kibernetike të ndodhura është parashikuar dhe përfshirja e mirëmbajtjes në nivel “serveri” për të rritur politikat e sigurisë së faqes zyrtare dhe azhurnimin e serverit me përditësimet e nevojshme.

Kërkesa për shpenzime operative për vitin 2023, në vlerën 23.6 milionë lekë është konsideruar si pjesë e politikës ekzistuese të Kolegjit të Apelimit.

Për dy vitet e tjera të PBA-së 2024 dhe 2025, kërkesa buxhetore për shpenzime korrente është përcaktuar **205.7 milionë** lekë pasi nuk është parashikuar rritje për nivelin e inflacionit sipas përcaktimeve në udhëzimin për hartimin e kërkesave buxhetore afatmesme dhe janë zbritur shpenzime që nuk konsiderohen të domosdoshme gjatë kësaj periudhe.

### 3. Shpenzimet për investime

Për vitin 2023, Kolegji i Posaçëm të Apelimit ka parashikuar në investime fondin **13.2 milion lekë**. Tavanit buxhetor i përcaktuar për vitin 2023 është **2 milionë lekë**. Përdorimi i këtij fondi për vitin 2023, parashikohet si më poshtë:

1. Prokurim për dy sete rezervë kompjuter dhe UPS, në vlerën 194 mijë lekë. Nga kontrolli i kryer nga specialistët IT të institucionit mbi funksionimin e pajisjeve kompjuterike të Kolegjit, ku ka rezultuar se këto pajisje janë në gjendje optimale pune, por duke pasur parasysh faktin që në vitin 2023, shumica e pajisjeve kompjuterike do të jenë në vitin e pestë të përdorimit duke rritur mundësinë e daljes nga përdorimi për shkak të defekteve dhe konsumit është vlerësuar blerja e këtyre pajisjeve rezerve për të mos cenuar aktivitetin e punës. Për efekt te tavanit të miratuar në investime, parashikimi për këtë grup (blerje pajisje elektronike) do të jetë në vlerën 1.000 mijë lekë.
2. Plotësim i kërkesës së paraqitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Publikun, për 5 (pesë) rafte metalike të mbyllura për vendosjen e fashikujve gjyqësorë nga specialistet e sekretarisë gjyqësore. Kosto e parashikuar për këto investime është llogaritur në vlerën 174 mijë lekë. Për efekt te tavanit të miratuar në investime, parashikimi për këtë grup (blerje pajisje zyre e mobilje) do të jetë në vlerën 1.000 mijë lekë.

Bazuar në përcaktimet e udhëzimit për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm, kjo kërkesë është trajtuar në kategorinë shpenzime administrative kapitale dhe përfshihet në politikat ekzistuese për projektet e investimeve publike.

3. Scanner për kontroll dhe urë metal dedektor, në vlerë **12,7 milion lekë**. Kjo është një kërkesë e përsëritur e Kolegjit prej vitit 2019, e cila nuk është miratuar. Theksojmë se ky investim garanton sigurinë e personelit të Kolegjit si dhe të palëve pjesëmarrëse në proces. Bazuar në përcaktimet e udhëzimit për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm, kjo kërkesë është trajtuar në kategorinë shpenzime për projekte investimesh dhe përfshihet në politikat e reja për projektet e investimeve publike.

Për gjithë sa parashtruar më sipër si dhe bazuar në nenin C/16, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkojmë mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj, për akordimin e plotë të buxhetit të kërkuar për vitin 2023, me qëllim realizimin e politikave të parashtruara nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në këtë fazë strategjike të hartimit të kërkesave buxhetore, në përmbushje të funksioneve që ligji 84/2016 dhe Kushtetuta e Shqipërisë i ngarkon këtij institucioni kushtetues.

Bashkëlidhur lutem gjeni tabelat plotësuese si dhe formatet standarde për hartimin e kërkesave buxhetore afatmesme 2023-2025.

Duke ju falënderuar për vëmendjen.